



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3110/2 prot.,

Datë 15.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR VENDIMIN E
VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALCANI” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

Ankimues: Operatori ekonomik “ALCANI” SHPK me Nipt J91505006Q
Adresa: Rruga e Laknasit, Blloku Frutikulturë 100 m pranë urës, Kamëz

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Rrogozhinë
Adresa: Lagjja 1, Rruga e Kavajës.

Në datën 14.12.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 3110 prot., e operatorit ekonomik “ALCANI” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ALCANI” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik, do të publikojë arsyet e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimes "ALCANI" SHPK, kundërshton në ankesën me nr. 3110 prot, datë 14.12.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Arsyet e refuzimit të ofertes janë për mos përmbushje kriteresh si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallrat objekt prokurimi të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave:

-leja mjedisore e paraqitur pa vulë elektronike dhe pa kokën e shkresës

2.3.4 Operatori duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara ambjent të përshtatshme për magazinimin e produkteve objekt prokurimi, për këtë qëllim operatori duhet të deklarojë vendodhjen e mallit dhe gjendjen aktuale të mallit që kërkohet, në mënyrë që të mund të verifikohet nga AK-ja-nuk është paraqitur as certifikate e pronësisë ,as kontratë qeraje nëse ka.

2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës si më poshtë:

- Të paktën një Automjet të përshtatshëm me kapacitet deri 3.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.*
- Të paktën një Automjet vetëshkarkues me kapacitet deri 3.5-7.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.*

Për automjetet në përputhje me kodin rrugor të paraqiten certifikatat e pronësisë, si dhe dokumentacioni përkatës; siguracioni, leja e qarkullimit, aktin e kolaudimit të automjetit në dispozicion-2 mjete të paraqitura janë mbi tonazhin e kërkuar. AA751TS-12.5 Ton deri në 18 Ton dhe TR7261K-10.3 Ton deri në 16 Ton.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 15.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro